



**A mund t'ju ofroni fëmijëve pa  
prindër një mundësi  
për të përjetuar ngrohtësinë familjare?**

Për më shumë informata, kontaktoni:  
Qendrën për Punë Sociale në komunën tuaj ose  
Organizatën e Fëmijëve pa kujdes prindëror, në tel: 038 613 888,  
email: [ofap.kosova@hotmail.com](mailto:ofap.kosova@hotmail.com)



**Strehimi Familjar**- është formë alternative e mbrojtjes sociale për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore. Kjo formë e mbrojtjes nënkupton vendosjen e përkohshme të fëmijës në një familje tjetër, atëherë kur qëndrimi i fëmijës në familjen biologjike është i pamundur.

**Familjet strehuese**- janë ato familje që kanë shprehur interesim për të ndihmuar këta fëmijë, dhe të cilat me pas vlerësohen dhe trajnohen nga Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe organizatat përkatëse, dhe aprovohen nga Paneli, pranë Departamentit për Politika Sociale dhe Familje në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Zbatimi, mbarëvajtja dhe zhvillimi i strehimit familjar është mandat dhe kompetencë e plotë territoriale e QPS-së komunale.

**Pyetjet që më së shpeshti i shtrojnë familjet e interesuar për strehim familjar:**

### **Si mund të bëhem familje strehuese?**

Procesi i aplikimit bëhet ashtu që ju, si familje e interesuar, duhet të paraqiteni tek Qendra për Punë Sociale në komunën tuaj dhe të ju tregoni atyre për interesimin tuaj për të strehuar fëmijët pa prindër në familjen tënde. Gjatë bisedës me ju zyrtari social do t'ju informojë në detaje për shërbimin e strehimit familjar, kushtet që duhet plotësuar, rolin tuaj, obligimet si dhe përgjegjësitë e të qenurit familje strehuese. Nëse zyrtari social vlerëson në takimin e parë me ju, se ju mund të jeni familje potenciale për të strehuar fëmijë, atëherë ai/ajo do t'ju informojë më hollësisht mbi dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurat tjera që duhet t'i ndiqni për t'u aprovuar si familje strehuese.

### **Çfarë cilësi duhet të kem për t'u bërë familje strehuese?**

Në përgjithësi familjet strehuese me të suksesshme janë ato familje të cilat janë mendjehapura, të besueshme, që i ofrojnë fëmijëve dashuri, ngrohtësi prindërore dhe janë të gatshme për të mësuar metoda të reja të prindërimit si psh. mbi edukimin e fëmijëve, përkujdesjen, disiplinimin dhe mbrojtjen e tyre. Aftësia për të qenë të gatshëm për ndryshime të reja dhe për të dëgjuar këshilla e sygjerime nga zyrtari social dhe profesionistë të tjerë janë cilësi, kualitete të rëndësishme për të qenë një familje e suksesshme strehuese.

### **A duhet të kem ndonjë shkollë apo trajnim special?**

Në disa shtete tjera kërkohet licenca, mirëpo në Kosovë kërkohen vetem trajnime speciale për strehim familjar. Sido që të jetë, QPS-ja në komunën tuaj do t'ju ofrojë trajnime të vazhdueshme (në bashkëpunim me organizata tjera që janë të licencuara në fushën përkatëse) por edhe përkrahje dhe këshilla gjatë gjithë kohës derisa fëmija është i strehuar tek ju.

### **Sa gjatë do të qëndroj fëmija në familjen strehuese?**

Kjo varet nga nevojat e fëmijës dhe rrethanat e tij/ saj për të qëndruar në një familje strehuese. Disa fëmijë mund të qëndrojnë vetëm disa muaj, derisa të tjerët mund të kenë nevojë të qëndrojnë deri një vit apo më shumë. Ndonjëherë fëmijët të cilët nuk mund të kthehen tek prindërit e tyre biologjik (kryesisht fëmijët e braktisur,) vendosen nga strehimit familjar në adoptim, pas disa muajve. Ndërsa fëmijët më të rritur, e sidomos fëmijët me aftësi të kufizuara mund të qëndrojnë më gjatë në strehim familjar derisa zyrtarët social bëjnë një zgjidhje të përshtatshme për ata fëmijë.

### **Cilët fëmijë vendosen në familje strehuese?**

Kryesisht në strehim familjar vendosen fëmijë pa kujdesje prindërore siç janë; foshnjat e braktisura menjëherë pas lindjes e që mund të jenë edhe me aftësi të kufizuara; fëmijë të lënë pas dore; fëmijë të keqtrajtuar nga prindërit apo kujdestarët e tyre dhe fëmijë që për arsye dhe rrethana të veçanta prindërit e tyre nuk mund të përkujdesen për ta për një periudhë të caktuar.

### **A ofrohet kompenzim material?**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë (MPMS) për çdo fëmijë të vendosur në familje strehuese ofron pagesen fillestare prej 75 euro dhe 250 euro në muaj. Nëse fëmija në strehim familjar është me aftësi të kufizuara atëherë MPMS ofron 350 euro në muaj për atë fëmijë. Këto të holla ofrohen për të mbuluar shpenzimet e fëmijës si për ushqim, veshmbathje dhe gjërat tjera të nevojshme për të. Përveq kompenzimit material nga MPMS, ka raste që disa komuna ofrojnë ndihmë financiare shtesë, të cilat mjete i dedikohen familjeve strehuese. Për shërbimet mjekësore QPS në komunën tuaj, përmes Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), e bënë kompenzimin për shërbimet mjekësore për fëmijën e strehuar.